

## Fotografia ndihmon për të gjallëruar interesin për kulturën shqiptare

Interviste ekskluzive për kombëtaren “Bota Sot” me albanologun e njohur Robert Elsie (2).

Albanologu i njohur kanadez Robert Elsie në vazhdim flet për botimet e ardhshme në lëmin e përkthimit, bashkëpunimet me institucionet kulturore në Kosovë, për daljen në dritë të librit të rrallë me fotografi “Dritëshkronja” (për fat të keq për arsye objektive ai nuk mori pjesë në promovimin në Prishtinë), etj.

[BS]: Në krijimtarinë tuaj enciklopedike jeni marrë me dialektologji, antologjitë e letërsisë shqipe, që nuk janë ndikuar së paku nga diktatet politike. Me këtë krijimtari mendoni se do të ndryshoni diçka, dhe çka do të shtoni?

[RE]: Thashë në fillim se në fushën e albanologjisë ka shumë për të bërë. Përpiqem sipas mundësive, tek tuk të shtoj ndonjë vepër. Kam ide për të ardhmen, dorëshkrimet e ndryshme që dëshiroj të botoj edhe që lidhen kryesisht me shkencën albanologjike. Do të shikoj nëse do t’i arrij. Plane kam shumë.

[BS]: Keni përfunduar me këngët kreshnike, kanunin, leksikun popullor të besimit shqiptar, pastaj keni studiuar autorët si Migjeni, Gjergj Fishta, Eqrem Basha, Visar Zhiti, etj. Konkretisht?

[RE]: Do të botoj një përkthim të poezive të Azem Shkrelit. Ky libër do të botohet në ShBA. Vonohet. Në fakt do të duhej të botohej para një viti e gjysëm. Tani mësova nga botuesi që do të dalë së shpejti në Los Anxheles. Është një botim në dy gjuhë, anglisht-shqip, i Azem Shkrelit, që e çmoj shumë. Përveç kësaj, besoj që në qershor do të botoj një antologji të madhe të poezisë shqipe. Poezinë shqipe që nga fillimi me Pjetër Budin, Lek Matrëngën e deri tek autorët bashkëkohore. Përfshihen në antologji rreth 50 autorë, saktësisht 48 autorë, dhe rreth 200-250 poezi të përkthyer në anglisht. Kjo antologji po ashtu do të botohet në ShBA dhe do të jetë pasqyrimi i parë i madh i letërsisë shqipe në botën angleze.

[BS]: Jeni anëtar i Shoqatës së Evropës Juglindore, anëtari i jashtëm i ASHAK-ut, njëherësh jeni dekoruar me medaljen e artë të Lidhjes së Prizrenit në vitin 2002 nga presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova, përkrah Rukes, Malcolmit. Jeni anëtar nderi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Prej prizmit nga jashtë, jo si i jashtëm, por nga jashtë, si e shihni në veçanti Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës? A ekziston apo jo?

[RE]: Në fakt, me Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës nuk kam pasur kontakte koha e fundit. Nuk mund të them asgjë për këtë. Unë di se letërsia krijohet në Kosovë. Për sa u përket shoqatave, dhe kësaj shoqate në veçanti, nuk kam njohuri.

[BS]: Gjatë qëndrimit të shkurtër këtu jeni takuar me dikë, ta zëmë në ASHAK?

[RE]: Po, isha në Akademi. Kemi shkëmbyer ide, mendime të ndryshme për projekte, etj. Akademia boton gjëra dhe bën punë me vlerë. Megjithëse si çdo gjë në Kosovë në kushtet e vështira.

[BS]: Në fund, vitin që sa po e lëmë pas, dolët me veprën, të themi të rrallë, qoftë nga botimi unikal, qoftë përmbajtësor të “Dritëshkronjes”. Pasi që nuk ishit në promovim, çfarë mund të

thoni sot? Një botim i veçantë, që nga fotografia e parë e gjetur deri më sot (1858) deri në vitin 1916. Në përgjithësi për fotografinë e në veçanti për “Dritëshkronja”?

[RE]: Jam shumë i interesuar për fotografinë e hershme. Përgjithësisht mungojnë fotografitë në historinë shqiptare. Fotografitë janë me shumë rëndësi, sepse historia e shkruar mund të shtrembërohet, të interpretohet në mënyrë të ndryshme, por fotografia tregon të vërtetën, siç ishte në atë kohë. Me mjetet e digjitalizimit të fotografisë sot, kemi mundësi fantastike për të qartësuar fotografi të vjetra, ndër të cilët i kam edhe në albumin fotografik ku në origjinal fotografitë në xham nuk shiheshin asgjë, por me përpunimin digjital për habinë time del fotografia dhe shihen figurat. Jam krejtësisht i habitur si kanë dalë disa fotografi. Më ka ndihmuar një teknik gjerman për përpunimin e fotografive. Nga një mjegull dolën figurat, dolën fshatarët me fëmijët e tyre, fshatarët shqiptarë, malësorët me pushkët e tyre, burra, gra, para një shekulli. Figurat më mahnitën shumë. Do të vazhdoj edhe më tej në lëmin e fotografisë. Kam ndërmend të botoj edhe një libër të dytë të fotografisë së shpejti, mbase në këtë vit, që do të jenë fotografi të vitit 1913, në një koleksion. Veçoria e këtij koleksioni është që janë fotografi me ngjyrë, që është një gjë e rrallë edhe në botë në përgjithësi në atë vit, e veçanërisht në Ballkan, pra fotografitë e para me ngjyrë në Ballkan, fotografi edhe të Shqipërisë, edhe të Kosovës në një album tjetër.

[BS]: “Dritëshkronja” është një botim i rrallë, i veçantë, një kontribut i madh. Vjen përherë të parë në një botim shqip, fotografia nëpër masat dhe pamjet e këtij botimi. Një digresion, një gërshetim mes asaj që kemi shkruar për historinë dhe letërsinë shqiptare dhe fotografisë?

[RE]: Kryesisht janë fotografi të panjohura deri tani. Shumica prej tyre nuk janë parë kurrë.

[BS]: Të ndihmon të shihni atë epokë, ato periudha me një sy tjetër?

[RE]: Po, më ndihmon edhe mua për të parë Shqipërinë siç ishte në atë kohë. Njerëzit ëndërrojnë për historinë, për figurat historike, ëndërrojnë edhe për figurat letrare, për Shqipërinë si ka qenë përpara. Tani kemi fotografinë e vërtetë. Duke hapur albumin, mund të takohemi me njerëz para më shumë se 100 vjetëve. Kjo fotografi në kopertinë, e asaj gruaje që rri pak e mërzitur mbi qilimin, në shtëpinë e saj në Shkodër, ajo (1863) ishte një shekull e gjysmë më herët. Ne takohemi me të drejtpërdrejt. Është diçka e mahnitshme. Besoj që fotografia ndihmon edhe në fushën e kulturës në përgjithësi për të gjallëruar interesin për kulturën shqiptare.

Bashkëbisedoi: Enver S. Morina.

[botuar në / *Bota Sot*, Prishtinë, 15 shkurt 2008, f. 23 / published in: *Bota Sot*, Prishtina, 15 February 2008, p. 23.]